



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____._____.2020

Burrel, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO” Sh.p.k, me numër Nipt-i: L51812001S, me seli: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.7, rruga “Frosina Plaku”, Pallati 21, Hyrja 1, Kati 2, dhe “HMK - Consulting” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L57129604Q, me seli: Tiranë, rruga “Zef Jubani”, pallati “Bjorn”, sh 3/5, ap. C/1, hyrja 20.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim - Shërbime”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: Loti 1: REF-67377-07-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti Nr. 1: “Mbikqyerje të punimeve për investimin me objekt: “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagja e Re, qyteti Burrel”, me fond limit: 1 496 331 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2020 në vlerën: 299 266 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për vitin 2021 në vlerën: 500 000 (pesëqind mijë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2022 në vlerën: 697 065 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, me afat realizimi të shërbimit: 6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 49 datë 03 Gusht 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO” Sh.p.k, me numër Nipt-i: L51812001S, dhe “HMK - Consulting” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L57129604Q

Vlera: 1 356 100 (një milion e treqind e pesëdhjetë gjashtë mijë e njëqind) lekë pa TVSH

2. Operatorin Ekonomik: “NET - GROUP” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L72023002P

Vlera: 1 356 100 (një milion e treqind e pesëdhjetë gjashtë mijë e njëqind) lekë pa TVSH

3. Operatorin Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A**

Vlera: **1 357 261** (një milion e treqind e pesëdhjetë shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “**NET - GROUP**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L72023002P**
2. Operatorin Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NET-GROUP” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

- I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.2/ 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.2.2 Vërtetim për deklarinimin e xhiros vjetore, lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet se xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se 90 % e fondit limit që prokurohet.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur Vërtetimin për deklarinimin e xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit.**

- II. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit të Shtojcës 7 në DST dhe përcaktimi i pikës 2.2.3/ 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”

*“2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**”*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në vërtetimet e paraqitura nuk konfirmohet shlyerja e të gjithë detyrimeve të matururara të energjisë elektrike, konkretisht nuk është paraqitur vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për muajin Qershor 2020 si detyrim i maturur.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale e tatim taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) punonjës për periudhën Qershor 2019 - Qershor 2020,

a) Të paraqiten:

- 1. Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Qershor 2019 - Qershor 2020*
- 2. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Qershor 2019 - Qershor 2020.”*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk janë paraqitur listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Qershor 2019 – Dhjetor 2019.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “b”, “c” dhe “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi*
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik*
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog*
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi*
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Topograf*

c) Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier i çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

d) Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier mjedisi të çertifikuar si “Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk na jepet informacion nëse stafi i kërkuar në gërmat “b”, “c” dhe “d” figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar, pasi nga ana e ofertuesit nuk janë paraqitur listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën e kërkuar në pikën/ gërmën “a” (Qershor 2019 – Dhjetor 2019).

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 (Makineri, Pajisje)

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Automjet	jo më pak se 1 copë
2.	Pajisje GPS	jo më pak se 1 copë

□ Për vërtetimin e disponimit të mjetit dhe pajisjes të kërkuara më lart, të paraqiten:

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (të vlefshme), Siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe Taksat e paguara.
 - 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (të vlefshme), Siguracionin e mjetit (të vlefshme), Taksat e paguara dhe Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
 - 3- Për pajisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi).
 - 4- Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi)
- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, afati i vlefshmërisë së Çertifikatave të Kontrollit Teknik dhe Siguracioneve të mjeteve, për të 2 (dy) automjetet e paraqitura kanë përfunduar përpara datës (10.08.2020) së hapjes/ zhvillimit të procedurës së prokurimit për të cilën ka marrë pjesë si ofertues.

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur analizën e përlogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila përbën kusht për s’kualifikim.

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit të Shtojcës 7 në DST:

“Ofertuesi duhet të deklarojë se: ...

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi deklarata e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik nuk është sipas formës së kërkuar në shtojcën 4 e përcaktuar në DST-së

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërmat “a”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1* nuk është sipas formatit të kërkuar dhe se i referohet një Autoriteti Kontraktor tjetër.

**III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:/
2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2017, 2018, 2019).”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur Kopje të vërtetuar të Bilancit për vitin e mëparshëm 2019.**

**IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “c” / 2.3 Për kapacitetin teknik/
Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

“c) Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier i çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, kontrata e paraqitur nuk është noteriale sipas kushtit të kërkuar.**

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila përbën kusht për s’kualifikim.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO”** Sh.p.k, me seli: *Tiranë, Njësia Bashkiake nr.7, rruga “Frosina Plaku”, Pallati 21, Hyrja 1, Kati 2*, me numër Nipt-i: **L51812001S**, dhe **“HMK - Consulting”** Sh.p.k., me seli: *Tiranë, rruga “Zef Jubani”, pallati “Bjorn”, sh 3/5, ap. C/1, hyrja 20*, me numër Nipt-i: **L57129604Q**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **1 356 100 (një milion e treqind e pesëdhjetë gjashtë mijë e njëqind) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** (Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike) me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **18.08.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor